

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI "HAMDI BERISHA"

2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



♦ Të dashur lexues,

Kjo është seria e dytë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Gjimnazit "Hamdi Berisha" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



NDRYSHIMET KLIMATIKE TASHMË KANË FILLUAR

Faktorët klimatikë tashmë kanë ndryshuar ndjeshëm ose janë në proces të ndryshimit, veçanërisht temperatura, reshjet dhe lagështia e ajrit.

Pa masa specifike të zbatuara në të gjitha nivelet (në rregullore, planifikim dhe zbatim të aktiviteteve) në përputhje me nevojat e natyrës, suksesi i njeriut në përshtatjen ndaj kushteve të ndryshuara klimatike është i pasigurt.

Në mënyrë që të gjithë sektorët e shoqërisë (industria, bujqësia, menaxhimi i ujit, pylltaria dhe të tjerë) të përshtaten me ndryshimet klimatike dhe të zhvillohen drejt zvogëlimit dhe përshtatjes ndaj efekteve të tij, kjo

temë duhet të trajtohet në rregullore dhe politika sektoriale. Duhet të planifikohen dhe zbatohen aktivitetet që janë të përshtatshme dhe në përputhje me natyrën. Zbatimi i Zgjidhjeve të Bazuara në Natyrë siguron rimëkëmbjen e ekosistemeve natyrore dhe funksioneve të tyre, duke ofruar përfitime të shumëfshta për njerëzit.

Tema e ndryshimeve klimatike duhet të integrohet në sistemin arsimor në të gjitha nivelet - nga ai parashkollor deri në arsimin e lartë - për të formuar breza që kuptojnë ndryshimet klimatike dhe veprojnë në përputhje me rrethanat. Një kulturë e veçantë, aktive për sigurinë e çdo individi si edhe për shoqërinë në tërësi është e nevojshme të krijohet.

NDIKIMI I URBANIZMIT NË KLIMË

Për shkak të kushteve të ndryshuara klimatike, kryesisht rritjes së temperaturës, shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve dhe periudhave të thata, si dhe me presionet në rritje të migrimit njerëzor, do të ndryshojë edhe mjedisi jetësor.

Ndryshimi i kushteve të jetesës do të shkojë gjithnjë e më shumë drejt urbanizimit.

Jini të gatshëm të përshtateni dhe të mësoni të jetoni në një mjedis që funksionon në kushte klimatike të ndryshuara.

Cilat janë zgjidhjet?

Zgjidhje të Bazuara në Natyrë: krijimi i hapësirave të gjelbra dhe blu në zonat urbane, ndërtimi i çative të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në qytete mund të zbusë ndikimin e valëve të të nxehtit duke ulur temperaturën mesatare ditore.

ZBN-të gjithashtu kontribuojnë në krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe rregullimin e temperaturës vjetore.

[HTTPS://WWW.IUCN.ORG/SITES/DEFAULT/FILES/2023-05/CLIMATE-CHANGE-IN-12-PICTURES_ALBANIAN.PDF](https://www.iucn.org/sites/default/files/2023-05/CLIMATE-CHANGE-IN-12-PICTURES_ALBANIAN.PDF)



MIGRIMI I POPULLSISË

Ndryshimet klimatike po krijojnë gjithnjë e më shumë kushte të patolerueshme jetese dhe pune, duke rezultuar në migrimin e popullsisë.

Arsyeja më e shpeshtë e migrimit është mungesa e kushteve elementare të jetesës, si uji i pijshëm dhe toka pjellore, por edhe dukuritë negative si rrëshqitjet e dheut.

Thatësira, erozioni, përmytjet, zjarret e mëdha dhe rrëshqitjet e tokës janë fatkeqësitë më të zakonshme, të cilat në kombinim me shfrytëzimin e tepërt dhe të paqëndrueshëm të burimeve, shkatërrojnë burimet natyrore të nevojshme për jetën.

Deri në vitin 2050, është vlerësuar se 700 milionë deri në 1 miliard njerëz do të detyrohen të ndryshojnë vendbanimin e tyre për shkak të humbjes së tokës së punueshme dhe fatkeqësive që vijnë nga kushtet e ndryshuara klimatike.

Cilat janë zgjidhjet potenciale?


masat për rikuperimin e habitateve natyrore, menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve agro-pyjore, stimuj për popullatën vendase për rritjen e racave të egra të kafshëve dhe kultivimin e varieteteve bimore që përshtaten me kushtet e reja mjedisore. Përftimet janë burime të mjaftueshme të ushqimit, rregullimi i ujit dhe zhvillimi socio-ekonomik.






AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EC MA NDRYSHE





DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.



EKO KLUBI "HAMDI BERISHA"

MALISHEVË, KOSOVO

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".